



Pranuar më: 07.03.2024			
Nr. org.	Nr. Nr.	Shkicë	Vlera
	1876		

Universiteti i Prishtinës
"Hasan Prishtina"

UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

Fakulteti i Mjekësisë

Bulevardi i Dëshmorëve p.n, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381-38-512221 URL: <http://www.uni-pr.edu>

Fax: +381-38-512223 Mail: mjekesia@uni-pr.edu

Ref. nr. Prishtinë, / / 2024

Bazuar në nenin 6, nën paragrafi 1.4, neni 47, nën paragrafi 1.1, përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 48, nën paragrafi 1.9 të Statutit të UPHP si dhe neni 4, paragrafi 3 të Rregullores për themelimin dhe parimet e funksionimit të Komisionit për etikë në hulumtimet shkencore, Këshilli i mësimi i Fakultetit të Mjekësisë në mbledhjen e mbajtur me datën: 23.02.2024 miratoi :

RREGULLORE PËR THEMELIMIN DHE PARIMET E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT PËR ETIKË NË HULUMTIMET SHKENCORE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 QËLLIMI

Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të ofroj mbështetje për stafin akademik dhe studentët e Fakultetit të Mjekësisë në hartimin e kërkesës së tyre për KEKSH dhe komisionin etik që funksionon në kuadër të Odave të Profesionistëve Shëndetësor dhe institucioneve tjera relevante. Komisioni etik ka rol për të siguruar që aktivitetet hulumtuese shkencore të ndërmarra nga hulumtuesit, studentët dhe palët e treta që kryejnë hulumtime në sferën e mjekësisë të jenë në përputhje me praktikat e mira kërkimore, parimet etike dhe të respektohen gjatë gjithë kohës.

Neni 2 SHKURTESAT

- Shkurtesat e përdorura në tekst kanë kuptimin si në vijim:
 - KEKSH**- Komisioni për Etikë në Kërkime Shkencore.
 - KEFM**- Komisioni etik i Fakultetit të Mjekësisë.
 - OPSH**- Odat e Profesionistëve shëndetësor dhe Institucionet tjera relevantes.

Neni 3
DETYRAT E KOMISIONIT ETIK

1. Të formuloj dhe përcaktoj politikat, procedurat dhe dokumentet standarde të bazuara në praktikat më të mira në lidhje me etikën në hulumtimet shkencore dhe të siguroj që këto politika të zbatohen brenda fushave të përgjegjesisë.

Neni 4
FUNKSIONET E KOMISIONIT ETIK

1. Të promovoj çështjet e etikës dhe integritetit në hulumtimet shkencore në nivel të Fakultetit.
2. Të siguroj që projekt-propozimi i hulumtimit është i fushës përkatëse nga edhe vjen profili i kandidatit që ka parashtruar kërkesë për leje të hulumtimit (në rastet kur hulumtimi është i një fushe tjetër të analizoj dobhtë dhe përfitimet nga ky hulumtim).
3. Të promovoj dhe monitoroj zbatimin e standardeve të miratuara të etikës të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe standardet etike.
4. Të shqyrtoj të gjitha aplikacionet e dorëzuara në KEFM dhe të siguroj që janë përfillur parimet etike kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe janë kompletuar të gjitha dokumentet e nevojshme.
5. Të siguroj se janë përfillur të gjitha normat ligjore përkatëse dhe kërkesat e agjencive rregullatore sa i përket legjislacionit në fuqi rreth çështjes së mbrojtjes së të dhënave personale.

Neni 5
PËRGJEGJËSITË E KOMISIONIT ETIK

1. Të kryej një shqyrtim të pavarur, kompetent, të paanshëm dhe në kohë reale të kërkesës për zhvillim të hulumtimit nga stafi akademik, studentët dhe palët e treta.
2. Të marrë vendime lidhur me kërkesat e dërguara për komisionin etik në lidhje me lejimin e zhvillimit të hulumtimeve dhe përfilljessë principeve etike.
3. Të siguroj dokumente standarde për aplikim në fushëveprimin përkatës, të siguroj që dokumentet e prezantuara janë në format e kërkuara, të siguroj që dokumentet e prezantuara janë në përputhje të plotë me standardet e KEKSH, OMK, OSK, ITR(nëse ka dokumente apo formular që kërkohen nga trupat tjera relevante).
4. Të propozoj (rekomandoj) KEKSH sugjerime të aspektit etik rreth projektit hulumtues të paraqitur në KEFM.
5. Të shtoj (plotësoj) me dokumente përkatëse nëse në projekt propozim të hulumtimit ka diçka që nuk është paraqitur (nëse kjo është e mundur dhe nuk bie ndesh me kompetencat e komisionit).
6. Këshilli i Fakultetit me vendim të veçantë mund ta ngarkojë me detyra shtesë KEFM.

II. PËRBËRJA E KEFM DHE PROCEDURAT E EMËRIMIT

Neni 6

PËRBËRJA (ANËTARËT) E KEFM

1. Komisioni Etik i Fakultetit të Mjekësisë përbëhet nga 9 (nëntë) anëtar të listuar si në vijim:

- 1.1 * Kryetari i komisionit.
- 1.2 * 2 Anëtar nga Mjekësia e Përgjithshme.
- 1.3 * 1 Anëtar nga Stomatologjia.
- 1.4 * 1 Anëtar nga Farmacia.
- 1.5 * 1 Anëtar nga Fizioterapia.
- 1.6 * 1 Anëtar nga Infermiera.
- 1.7 * 1 Anëtar përfaqësues nga Këshilli i studentëve.
- 1.8 * 1 Anëtar nga stafi joakademik.

1.1. Kriteri minimal për emërim për anëtar të Komisionit etik të Fakulteti të Mjekësisë duhet të jetë titulli i Doktorit të shkencave mjekësore.

2. Sipas vlerësimit të menaxhmentit dhe këshillit të Fakultetit, komisioni mund të ndryshoj përbërjen dhe të plotësohet me anëtarë shtesë (maksimumi i anëtarëve të KEFM mund të jetë 15).

Neni 7

PROCEDURAT E PROPOZIMIT, EMËRIMIT (APROVIMIT) TË PËRBËRJES SË KEFM

1. Anëtarët e KEFM zgjedhën nga Këshilli i Fakultetit me propozimin e Dekanit.
2. Me propozim të Dekanit njëri nga anëtarë e KEFM zgjedhet kryetar i komisionit.
3. Këshilli i Fakultetit mund ta aprovoj ose ta refuzoj përbërjen e KEFM-së.
4. Në rast të refuzimit nga Këshilli, Dekani paraqet përbërjen e re të KEFM-së në afatit prej 30 ditësh.

Neni 8

PROCEDURAT E SHKARKIMIT TË KEFM

1. Me propozim të Dekanit këshilli i Fakultetit mund të shkarkoj komisionin apo ndonjërin nga anëtarët e komisionit.
2. Anëtari i komisionit mund të shkarkohet (ndërrohet) në rast se i njëjti:
 - 2.1 Jep dorëheqje.
 - 2.2 Nuk merr pjesë në mbledhje/takime të rregullta (mungon 3 herë pa ndonjë arsye).
 - 2.3 Në rast të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, automatikisht pushon edhe funksioni i anëtarit të komisionit.
 - 2.4 Në rast të zgjedhjes në pozita menaxheriale në Fakultet apo në Universitet.
 - 2.5 Anëtari i KEFM i cili mund të ketë konflikt interesi në ndonjë projekt propozim për hulumtime nuk lejohet të marrë pjesë në diskutimet dhe votimin për atë projekt.
3. Anëtari i komisionit është i obliguar të deklaroj nëse ka konflikt interesi në emërimin e tij në KEFM, dhe i njëjti nuk mund të zgjedhet anëtari KEFM.
4. Mandati i KEFM përfundon me përfundimin e mandatit të këshillit të Fakultetit.

III. PARIMET E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT ETIK TË FAKULTETIT TË MJEKËSISË

Neni 9

MBLEDHJET/TAKIMET E KEFM, SHQYRTIMI I APLIKACIONEVE

1. KEFM organizon mbledhje/takim pune së paku një herë në muaj(data, ora dhe vendi i takimit propozohet nga kryetari i komisionit dhe miratohet me shumicë votash nga anëtarët e komisionit)
2. Orari i takimeve vjetore të KEFM publikohet në web faqen e fakultetit, së bashku me të edhe dokumentet standarde (formularët) të miratuara nga KEFM.
3. Komisioni organizon mbledhje edhe më shpesh nëse kjo është kërkesë nga menaxhmenti i Fakultetit(dekani) në raste kur kjo është e nevojshme.
4. Mbledhja e komisionit mund të mbahet nëse ka kuorum(50% +1 anëtar)
5. Vendimet konsiderohen të vlefshme nëse miratohen me shumicë votash.
6. Anëtari i komisionit nga stafi jo-akademik pranon aplikacionet dhe i dërgon anëtarëve të komisionit në mënyrë elektronike (të skanuara) të gjitha dokumentet e pranuar dhe në bashkëpunim me kryetarin e komisionit përgatitin raportin për mbledhje/takim të KEFM.
7. Aplikacionet duhet të dorëzohen së paku 3 dite pune para mbledhjes/takimit të KEFM.
8. Aplikacionet e dorëzuara jashtë këtij afati nuk shqyrtohen në atë mbledhje/takim por mbesin për mbledhjen/takimin e radhës.
9. Raporti i përgatitur nga anëtari i komisionit nga radhët e stafit jo-akademik prezantohet në mbledhje/takim të KEFM nga kryetari i komisionit(në rast të mungesës së kryetarit, raportin e prezanton dikush nga anëtarët e komisionit të cilin e autorizon kryetari).

Neni 10

VENDIMMARRJA, HARTIMI DHE MIRATIMI I DOKUMETEVE

1. Të gjitha vendimet e marra nga KEFM nënshkruhen nga kryetari i KEFM, protokolohen në arkivën e Fakultetit dhe u dorëzohen aplikantëve si dhe përcillen në mënyrë zyrtare institucioneve relevante.
2. KEFM mund të vendos të kërkoj sqarime shtesë për aplikacionin, aplikanti është i obliguar që këto sqarime shtesë t'i paraqes në afat prej 15 ditësh.
3. Në rast të mosparaqitjes së sqarimeve të kërkuara brenda afatit të përcaktuar aplikacioni për aprovim të hulumtimit konsiderohet i refuzuar.

Neni 11
RAPORTIMI I KOMISIONIT ETIK

1. Kryetari i KEFM i raporton Dekanit për takimet që zhvillohen.
2. Raportimi i Kryetarit të KEFM bëhet sipas kërkesës së Dekanit.
3. Kryetari i KEFM i raporton një herë në vit Këshillit të Fakultetit (në raste të veçanta edhe më shpesh kur kjo kërkohet nga Dekani apo Këshilli i Fakultetit).

IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 12
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Fakultetit dhe ratifikimit nga Senati i UP-së.
2. Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje janë edhe formularët e procedurave të aplikimit për kërkime/hulumtime shkencore.
3. Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj rregulloreje bëhet në të njëjtën procedurë me të cilën është miratuar dhe ratifikimit.

Prof. Dr. Suzana Manxhuka – Kërliu

Dekane e Fakultetit të Mjekësisë



